



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Numër: DES 3 / 2002

Date: 11.01.2002

Lënda: Universiteti Boshnjak – Bursat e studentëve

Në përputhje me rregullorën e UNMIK-ut nu. 2000/11 të 3 Marsit 2000, mbi themelimin e Departamentit Administrativ për Arsim dhe Shkencë, dhe në përputhshmëri me rregullorën nu. 2001/19 të 15.05.2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë, kapitulli IV Mbi të drejtat e Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, Departamenti Kalimtarë i Administratës për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (më poshtë: DKAAST) lëshon këtë udhëzim administrativë.

Neni 1

Qëllimi

- 1.1. Qëllimi i këtij udhëzimi administrative është që të përcaktojë dhe themelojë politikën dhe kriteret e DKAAST mbi dispozitat e mbështetjes financiare për studentët me gjendje jo të favorshme ekonomike dhe të cilët janë anëtarë të komunitetit Boshnjak në Kosovë.

Neni 2

Bursat

- 2.1. Duke marrë në konsideratë mundësitë e pamjaftueshme të studentëve boshnjak për tu shkolluar në arsimin e lartë në gjuhën e tyre, DKAAST do të vendosë një shumë fondesh për të themeluar një fond bursash për studentët Boshnjak të cilët janë duke studiuar në Universitetin e Sarajevës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe të cilët plotësojnë kushtet e nevojshme të paraqitura në këtë udhëzim.
- 2.2. Bursat do të kenë shumën prej 800 € për një vit akademik dhe do të paguhën në baza semestrale.
- 2.3. Sasia e mjeteve prej 800 € për secilin vit shkollorë është që të plotësojë nevojat e jetesës dhe jo të zbatohet për shpenzime pagesash universitare apo ndonjë shpenzim tjetër me karakter akademik.
- 2.4. Sasia e mjeteve prej 800 € për vit akademik mund të ngritët apo ulët varësisht nga fondet e pranueshme mbi inflacionin.

Neni 3

Kërkesat e nevojshme

- 3.1. Aplikantët duhet të përmbushin këto kritere:

- a) Studentët duhet ti përkasin Komunitetit Boshnjak në Kosovë
- b) Studentët duhet të pranohen ose regjistrohen si të rregullt në njërin nga fakultetet e Universitetit të Sarajevës.
- c) Studentët duhet të paraqesin një vërtetim për suksesin e arritur në vitin paraprak akademik.
- d) Studentët duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se ata janë duke kaluar nëpër vështirësi financiare apo janë me gjendje të vështirë financiare.

Neni 4

Kërkesat për aplikim

- 4.1. Të gjithë aplikantët për bursë duhet të paraqesin një aplikacion me shkrim të udhëheqësi I sektorit të universiteteve (më tutje udhëheqësi I sektorit) për tu marrë në shqyrtim.
- 4.2. Përveq aplikacionit ata duhet të paraqesin edhe:
 - a) Një transkript zyrtarë të qertifikuar; ose
 - b) Një transkript zyrtar të qertifikuar nga universiteti nëse studenti është duke vazhduar studimet në universitet.
 - c) Një dokument zyrtar nga Universiteti i Sarajevës i cili thekson që studenti është i pranur si i rregullt në njërin nga fakultetet e universitetit.

Neni 5

Procesi i selektimit

- 5.1. Të gjithë aplikantët duhet të procesohen dhe rishiqohen nga udhëheqësi i sektorit.
- 5.2. Zgjedhja e kandidatëve varët nga fondet e gatshme dhe duhet të bazohet në:
 - a) të dhenat akademike (gradat dhe notat e arritura)
 - b) nevojat e aplikantëve (bazuar në informatat e paraqitura në aplikim)
 - c) aktivitetet shkollore (sportet, klubet etj)
 - d) aktivitetet e jashtme (punët, qështje vullnetare etj.)
 - e) dhe faktorë tjerë që mund të dukën të arsyeshëm për udhëheqësin e sektorit.
- 5.3. Pasi që të zgjidhet aplikanti, udhëheqësi i sektorit duhet të autorizojë zyrën për financa të universitetit që të procesojë pagesën për aplikantët e suksesshëm.

Neni 6

Kohëzgjatja dhe përsëritja e bursës

- 6.1. Secila bursë duhet të jipet për një vit akademik dhe mund të ripërsëritet për secilin vit të ri akademik.
- 6.2. Studentët të cilët kërkojnë që ta ripërtërijnë bursën në vitin pasues akademik duhet të paraqesin kërkesën me shkrim të udhëheqësi i sektorit jo më vonë se një muaj para paraqitjes së vitit të ri akademik.
- 6.3. Udhëheqësi i sektorit të universiteteve duhet të aprovojë përsëritjen e bursës duke siguruar që studenti aplikuaes:
 - a) vazhdon të përmbush kërkesat e nevojshme të bursës, dhe
 - b) të paraqitet vërtetimi për suksesin e arritur gjatë vitit akademik.
- 6.4. Në rast të dështimit për të iu përgjegjur këtyre kriterëve në nenin 6.3 e tëra kjo rezulton në anulim të bursës pa ndonjë lajtmrim.

Neni 7

Hyrja në Fuqi

- 7.1. Ky udhëzim hyn në fuqi me 11 Janar 2002

Paul Daveney
Zyrtar Përgjegjës
Departamenti Kalimtar i Administratës
së Arsimit, Skencës dhe Teknologjisë